



Funded by
the European Union

Just
React 

Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje

Korrik 2023 – Qershor 2024

Nëntor 2024



Grupi për Studime
Juridike dhe
Politike





Funded by
the European Union



Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje

Korrik 2023 – Qershor 2024

Autor:

Renata Bajrami

Kontribues:

Dinore Xhemajli, Elza Tullari, Ilir Koçani,
Erëblina Polloshka, Jetlira Sallteku.

Nëntor 2024

Projekti "JUST REACT – Boosting Civic Reaction towards an Improved Access to Justice in Kosovo" financohet nga Bashkimi Evropian dhe implementohet nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) në bashkëpunim me Fondin për Zhvillimin e Komunitetit (CDF).

* Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Fondit për Zhvillim Komunitar (CDF) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Grupi për Studime
Juridike dhe
Politike



Përmbajtja

HYRJE.....	04
METODOLOGJIA.....	06
KORNIZA LIGJORE AKTUALE PËR MBROJTJEN NGA DHUNA NË FAMILJE NË KOSOVË.....	07
1. RAPORTIMI I RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË POLICINË E KOSOVËS.....	12
1.1 Shpërndarja rajonale e rasteve të raportuara në policinë e Kosovës për dhunën në familje.....	12
1.2 Aspekti gjinor në rastet e dhunës në familje.....	14
1.3. Roli i marrëdhënieve familjare në dinamikat e dhunës në familje	15
1.4. Analiza demografike e viktimave dhe të dyshuarve të dhunës në familje.....	16
II. TRAJTIMI I RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE NGA PROKURORI I SHETIT.....	18
2.1 Kallëzimet Penale dhe Ngritja e Aktakuzave: Nisma për Drejtësi dhe Mbrojtje	18
2.1.1 Ndarja rajonale e aktakuzave për dhunën në familje.....	19
2.2. Vlerësimi i performancës së Prokurorit të Shtetit në rastet e dhunës në familje: Efikasiteti dhe Sfidat.....	20
III. TRAJTIMI I RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE NGA GJYKATA THEMELORE NË KOSOVË.....	22
3.1. Vlerësimi i performancës së Gjykatave Themelore në rastet e dhunës në familje.....	22
3.1.1. Përmbledhja e verdikteve finale mbi rastet e dhunës në familje nga ana e Gjykatave Themelore në Kosovë.....	24
3.2. Vendimet gjyqësore në Rastet e Dhunës në Familje: Një Analizë e Thelluar e Mostrës.....	24
3.2.1. Kohëzgjatja e procedurës.....	25
3.2.1.1. Lloji i dhunës.....	26
3.2.1.2. Aspekti gjinor dhe raporti mes palëve procedurale.....	27
3.2.1.3. Statusi ekonomik i palëve procedurale.....	28
3.2.2. Analiza e Politikës Ndëshikmore.....	29
3.3 Përceptimet nga Terreni: Analiza përmes Monitorimit të Drejtpërdrejtë.....	31
GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	34

Hyrje

Dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore në Kosovë vazhdojnë të përbëjnë shqetësim për shoqërinë dhe institucionet. Ky raport, i hartuar në kuadër të projektit "JUST REACT – Rritja e Reagimit Qytetarë për një Qasje të Përmirësuar në Drejtësi në Kosovë," financuar nga Bashkimi Evropian, paraqet një analizë gjithëpërfshirëse mbi trajtimin institucional të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore për periudhën korrik 2023 - qershor 2024. Raporti synon të vlerësojë qasjen institucionale ndaj këtij fenomeni përmes kapitujve të strukturuar që mbulojnë procesin e raportimit, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të dhunës, duke propozuar gjithashtu rekomandime të detajuara për përmirësimin e qasjes në drejtësi dhe mbrojtjen e viktimave.

Vlen të theksohet se në Raportin e Komisionit Evropian (KE) për Vendin, përpjekjet institucionale për trajtimin e dhunës në familje dhe avancimin e barazisë gjinore kanë treguar përmirësime, veçanërisht në fuqizimin e kornizës ligjore. Megjithatë, sfidat mbeten në përforcimin e zbatimit të këtij legjislacioni dhe në sigurimin e qasjes së barabartë për gratë në drejtësi.¹ Në linjë me të gjeturat dhe rekomandimet e këtij raporti (paraqitur në kapitujt vijues) raporti i KE thekson nevojën për ndërhyrje më të fuqishme për të përmirësuar mbështetjen institucionale për viktimat, çka përputhet me analizën tonë në kapitujt vijues.²

Fillimisht, raporti trajton kornizën ligjore për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, duke elaboruar bazën kryesore për trajtimin e mëtutjeshëm të tematikave që ndërlidhen me trajtimin institucional të rasteve të dhunës në familje.

Ky raport hulumtues fokusohet në tri hallkat kryesore institucionale të trajtimit të rasteve të dhunës në familje: policia, prokuroria dhe gjykatat.

Në kapitullin e parë, analizohen të dhënat e ofruara nga Policia e Kosovës, me theks në shpërndarjen rajonale të rasteve të raportuara, shpërndarjen demografike, raportin mes palëve procedurale dhe pjesëmarrjen gjinore. Në kapitullin e dytë vlerësohet performanca e Prokurorive Themelore duke analizuar trajtimin e kallëzimeve penale dhe ngritjen e aktakuzave që lidhen me rastet e dhunës në familje. Në kapitullin e tretë, i cili trajton Gjykatat Themelore, synohet një analizë gjithëpërfshirëse e rolit të këtij institucioni, duke përfshirë të dhëna nga tre këndvështrime: monitorimi i seancave nga monitoruesit e angazhuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, analizimi i të dhënave të ofruara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), si dhe analizimi i një mostre të aktgjykimeve. Për secilin institucion do të ofrohen të dhëna cilësore dhe sasiore, duke ofruar kështu një qasje gjithëpërfshirëse në mënyrë që të identifikohen sa më shumë elemente dhe rrjedhimisht faktorët drejt ngërçeve eventuale që mund t'i ketë sistemi si rezultat i sfidave gjithnjë e më të mëdha në këtë drejtim.

Kur jemi tek rëndësia e raportimit të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, vlen të përmendet se Grupi për Studime Juridike dhe Politike, ka lansuar aplikacionin "**Afër Teje**" në vitin 2019, përmes të cilit synon të jetë sa më afër viktimave apo edhe viktimave potenciale të dhunës në familje si dhe dhunës me bazë gjinore. Aplikacioni Afër Teje, përveç që liston insti-

1 Komisioni Evropian. Raporti për Kosovën, 2024, fq.36., i qasshëm në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf

2 Po aty.

tucionet përgjegjëse për ofrim të ndihmës në kuptim të mbrojtjes së të drejtave të këtyre kategorive, përfshin gjithashtu edhe vendndodhjen e tyre, numrat kontaktues, email adresat në të cilat mund t'i drejtohen. Gjithashtu ky aplikacion ka edhe një komponentë e cila mundëson navigimin nga vendndodhja ku ndodhet personi që është subjekt potencial i dhunës deri tek zyra më e afërt, qoftë ajo e Policisë, Ndhmës Juridike Falas, Avokatit të Popullit, Gjykatave, etj. Për periudhën korrik 2023 – qershor 2024 u regjistruan **1,008 përdorues aktiv** të aplikacionit, ndërsa ka pasur më shumë se 2000 përdorues që e kanë shkarkuar në telefonat mobil të tyre.

Për të mbështetur më tej viktimat, platforma përfshin një funksionin e thirrjes emergjente që i lejon viktimat të zgjedhin paraprakisht një kontakt emergjent. Për më tepër, ofron optionin për të ndryshuar ikonën e aplikacionit në platformat Android dhe iOS dhe të simulojë një telefonatë të rreme për të ndihmuar përdoruesit të shmangin ndonjë situatë që mund të përshkallëzohet në konflikt.

Metodologjia

Të dhënat për këtë raport janë siguruar nga tre burime kryesore: **të dhënat zyrtare nga institucionet kyçe të përfshira në trajtimin e rasteve të dhunës në familje**, përkatësisht **Policia e Kosovës (PK), Prokurori i Shtetit (PSH) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)**; të dhënat e mbledhura përmes monitorimit të kryer nga ekipi i **JUST REACT**; si dhe të dhënat nga aktgjykimet e publikuara nga KGJK. Të dhënat u mbledhën dhe u analizuan për periudhën nga **1 korriku i vitit 2023 deri në 30 qershor të vitit 2024**.

Pjesa fillestare e të dhënave të shfrytëzuara në këtë raport është mbledhur nga **burime zyrtare** brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës. Këto të dhëna përfshijnë statistika lidhur me **raportimet, aktakuzat dhe rastet e gjykuara** në lidhje me rastet e dhunës në familje. Këto informacione u shqyrtuan për të vlerësuar tendencat dhe modelet përgjatë kornizës së specifikuar kohore. Vlen të theksohet se në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), ky raport përdor tre nga treguesit kryesorë të kësaj metodologjie për vlerësimin e performancës së sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial në Kosovë: **Norma e Zgjidhjes së Lëndëve (Clearance Rate %), Norma e Qarkullimit të Lëndëve (Case Turnover Ratio) dhe Koha e Zgjidhjes së Lëndëve (Disposition Time)**. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se gjatë procesit të monitorimit, ekipi i Just React është përballur me **vështirësi për shkak të mungesës së një databaze të përbashkët** ndërmjet prokurorisë dhe gjykatave, e cila do të mundësonte një vlerësim gjithpërfshirës të secilit rast, që nga **ngritja e aktakuzës e deri në vendimin përfundimtar**.

Së bashku me të dhënat zyrtare, **ekipi i JUST REACT zhvilloi aktivitete monitoruese** për të arritur perceptcion shtesë lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës në familje në Kosovë. Procesi i monitorimit përfshiu analizën e **57 aktgjykimeve** të publikuara nga KGJK duke e vënë theksin në **mesataret e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore në nivel rajonal, llojin e dhunës, raportet mes palëve procedurale si dhe analizimin e politikës ndëshkimore**.

Një aspekt tjetër i procesit të monitorimit është **monitorimi sistematik i seancave gjyqësore** lidhur me rastet e dhunës në familje, për çka është organizuar **një fokus grup me monitoruesit e angazhuar** për të shpalosur përvojat e tyre. Vlen të theksohet se ekipi ruajti me kujdes konfidencialitetin e këtyre procedurave gjatë mbledhjes së të dhënave thelbësore. Kjo metodë i mundësoi ekipit të arrinte një perceptim të drejtpërdrejtë mbi dinamikën e sallës së gjyqit dhe mënyrën në të cilën në të cilën u trajtuan rastet.

Korniza ligjore aktuale për mbrojtje nga rastet e dhunës në familje në Kosovë

Dhuna në familje përbën çështje më urgjencë brenda Republikës së Kosovës në aspektin social dhe jo vetëm. Megjithatë, në periudhën korrik 2023 – qershor 2024, vërehet një fokus i shtuar në trajtimin institucional të dhunës në familje në drejtim të avancimit të kornizës ligjore në këtë fushë.

Për sa i përket kornizës ligjore, Republika e Kosovës ka ndërmarrë disa veprime për të adresuar këtë "pandemi," me qëllim të garantimit të të drejtave themelore të njeriut dhe me fokus në garantimin e barazisë gjinore.

Më konkretisht, **në vitin 2023** korniza ligjore për trajtimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë ka pësuar përmirësime të ndjeshme, me qëllim të harmonizimit të legjislacionit vendas me standardet ndërkombëtare, veçanërisht me **Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje** (Konventa e Stambollit).

Kodi Penal i Kosovës (tutje: Kodi), në definimin e dhunës në familje, fokusohet kryesisht në qëllimin e kryerësit për të cenuar dinjitetin e viktimës përmes **dhunës fizike, psikologjike ose ekonomike**.³ Me këtë përkufizim, Kodi vendos theksin në trajtimin e dhunës në familje si një krim që meriton ndëshkim të drejtpërdrejtë me gjobë dhe me burgim, duke krijuar një bazë të qartë për përgjegjësi penale në rastet e dhunës në familje.⁴ Ndërsa, Konventa e Stambollit përqendrohet në dhunën si një shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi gjinor, veçanërisht ndaj grave.⁵

Duke e trajtuar dhunën në familje brenda një kuadri gjithëpërfshirës, Konventa përfshin jo vetëm marrëdhëniet tradicionale familjare, por edhe ato mes ish-partnerëve dhe partnerëve aktualë, duke e bërë të qartë se dhuna mbetet e tillë pavarësisht nëse autorët dhe viktimat ndajnë ose kanë ndarë të njëjtën banesë.⁶

Në këtë drejtim, **Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore** (tutje: ligji i ri), i miratuar në tetor 2023, zëvendësoi **Ligjin nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje** (tutje: ligji i vjetër), duke sjellë risi në masat e reja shtesë dhe duke rritur përgjegjësinë institucionale. Po ashtu me këtë ligj definohet qartë fushëveprimi i tij duke përcaktuar detyrimin e institucioneve publike, private, shoqërisë civile dhe profesionistëve të tjerë për të ofruar ndihmë dhe mbrojtje për viktimat e dhunës në familje.⁷ Ligji i ri përcakton detyrat dhe përgjegjësitë specifike për institucionet si:

3 Kodi nr.06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 248, paragrafi 1, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=435>

4 Po aty.

5 Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), neni 3, i qasshëm në: [CETS 210 - Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence](#)

6 Po aty.

7 Analizë krahasuese mes legjislacionit të vjetër dhe të ri për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore, Vlerë Avdiu (praktikante në programin JUST React), fq. 5. E qasshme në: [Analiza-Ligjore-JUST-REACT.pdf](#)

- **Mbrojtësit e Viktimave;**
- **Policinë e Kosovës;**
- **Ministrinë për Mirëqenie Sociale;**
- **Qendrat për Punë Sociale** dhe agjenci të tjera.



Urdhri i mbrojtjes



Ndhimja ligjore



Rehabilitimi



Denimet për shkelesit

Me këtë ligj zgjerohet edhe koncepti i dhunës në familje për të përfshirë të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike që ndodhin brenda një marrëdhënieje familjare ose njësie shtëpiake, por edhe dimensionet e kontrollit dhe vartësisë në marrëdhëniet familjare dhe intime. Kjo nënkupton që dhuna nuk përfshin vetëm aktet fizike, por edhe elemente të tjera të kontrollit që ndikojnë në pavarësinë dhe dinjitetin e viktimës, duke ofruar një mbrojtje më të gjerë dhe më të avancuar. Në përgjithësi, zbatimi i plotë i këtij ligji nga ana e institucioneve ligjzbatuese përbën një hap kyç për të adresuar jo vetëm rastet individuale të dhunës në familje, por edhe për të luftuar rrënjët strukturore të dhunës me bazë gjinore në shoqërinë kosovare.

Dokument i rëndësishëm në saje të kornizës ligjore në Kosovë është edhe **Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026** (tutje: Strategjia).⁸ Strategjia është një dokument i cili synon të përmirësojë mbrojtjen e grave dhe të individëve të tjerë që përjetojnë dhunë në familje. Kjo strategji përcakton objektiva specifike për forcimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese, përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndihmën e menjëhershme për viktimat e dhunës.

Një nga objektivat e strategjisë është lansimi i programit për trajtimin e kryerësve të dhunës ndaj grave, i cili deri në qershor të vitit 2024 ka qenë projekt-pilot për periudhë 6 mujore në Qendrën Korrektuese të Dubravës.⁹

Për më tepër, gjatë vitit 2023 **Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale** të Kosovës gjithashtu kanë pësuar ndryshime. Ndryshimet përfshijnë **zgjerimin e përkufizimeve të dhunës dhe parashikimin e dënimeve më të ashpra** për veprat që lidhen me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Këto ndryshime synojnë të përmirësojnë mbrojtjen e viktimave dhe të sigurojnë drejtësi efikase, duke përfshirë afate më të shkurtra për hetimin dhe përfundimin e gjyqimeve.

Më konkretisht, **Ligji nr. 08/L-188 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal nr. 06/L-074 të Republikës së Kosovës**¹⁰, përfshin masa shtesë për personat e shpallur fajtorë për veprat penale të dhunimit dhe dhunës në familje. Disa nga ndryshimet kryesore janë:

8 Ministria e Drejtësisë. Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026. E qasshme në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/9307CD0A-E63D-4DCE-A93C-39698DE65A2F.pdf>

9 Ministria e Drejtësisë. "Lanohet Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave". Qasur më 28.10.2024. <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,3161>

10 Ligji nr.08/L-188 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal nr.06/L-074 të Republikës së Kosovës, neni 2, 4 dhe 5, i qasshëm në: [Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës](#)

- **Ndalimi i përfitimeve nga burimet publike:** Për një periudhë nga 3 deri në 10 vite, personave të dënuar u ndalohet blerja e pronave dhe asetëve publike, aplikimi si investitor strategjik dhe përfitimi nga privilegjet publike.
- **Ndalimi i kandidimit dhe punësimit në sektorin publik:** Ligji ndalon kandidimin për pozita publike dhe punësimin në sektorin publik për të dënuarit për këto vepra.
- **Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur:** Çdo person i dënuar për dhunim dhe dhunë në familje humb të drejtën për t'u zgjedhur në pozita publike për një periudhë nga 3 deri në 10 vite.
- **Zgjerimi i kompetencave të gjykatave:** Gjykatat kanë autorizimin të ndalojnë punësimin në sektorin publik (1-5 vite) dhe drejtimin e automjeteve (1-5 vite) për personat e dënuar që kanë ushtruar profesionin e vozitësit në kohën e kryerjes së veprës.¹¹

Ndërsa, Kodi i Procedurës Penale, i vitit 2022 është ndryshuar përmes **Ligjit nr. 08/L -187 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale**.¹² Si synim i këtij plotësim-ndryshimi është përshpejtimi i procedurave për veprat penale të dhunës në familje:

- **Shkurtimi i afateve të hetimit:** Hetimet për këto vepra duhet të përfundojnë brenda **një (1) viti** nga data e fillimit të hetimit. Në raste të ndërlukuara, afati mund të zgjatet edhe për **gjashtë (6) muaj**.
- **Vendosja e afateve të reja për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor** si në vijim:
 - **Gjashtëdhjetë (60) ditë** për rastet e trajtuara nga gjyqtarët e vetëm gjykues.
 - **Nëntëdhjetë (90) ditë** për rastet e trajtuara nga trupi gjykues.¹³

Me këto ndryshime synohet të sigurohet efikasitet dhe prioritizim i rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, me ç'rast pasqyrohet në mbrojtje më të madhe ndaj viktimave. Suksesi i këtyre ndryshimeve varet nga kapaciteti i gjykatave për të përmbushur këto afate në mënyrë efektive.

Korniza e brendshme ligjore sa i përket dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, është si në vijim:

1. Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074;
2. Ligji nr.08/L-188 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal nr.06/L-074 të Republikës së Kosovës;[41] Kodin nr.08/L-032 të Procedurës Penale
3. Ligji nr.08/L-187 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Procedurës Penale nr.08/L-032;
4. Ligji nr.03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (i shfuqizuar në tetor 2023 me miratimin e Ligjit të ri);
5. Ligji nr.08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore;

¹¹ Po aty.

¹² Ligji nr. 08/L -187 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, neni 2 dhe 3. I qasshëm në: [ActDocumentDetail.aspx \(rks-gov.net\)](https://rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx)

¹³ Po aty.

6. Ligji nr.05/L -003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës;
7. Ligji nr.05/L-020 për Barazinë Gjinore;
8. Ligji nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
9. Ligji nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit (i shfuqizuar në nëntor 2022 me miratimin e ligjit të ri);
10. Ligji nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit;
11. Procedurat Standarde të Veprimit për Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave (Prokuroria);
12. Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë (Agjencia për Barazinë Gjinore);
13. Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale në Kosovë.

Kushtetua e Republikës së Kosovës, në nenin 22 të saj ka të renditura gjithsej nëntë (9) instrumente ndërkombëtare drejtpërdrejtë të zbatueshme si në vijim:

14. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
15. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
16. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
17. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
18. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
19. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
20. Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
21. Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese;
22. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).¹⁴

Tetë nga këto instrumente të renditura janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës për më shumë se dy dekada.¹⁵ Ndërsa, Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) është e zbatueshme që nga miratimi i amendamentit nr. 26 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me datë 25 shtator 2020. Është e vlefshme të theksohet se Konventa e Stambollit, parasheh se palët duhet të jenë aktive karshi ndërmarrjes së masave të qarta dhe efektive për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i mbajtur përgjegjës kryerësit.¹⁶

14 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22 dhe Amendamenti nr. 26, të qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

15 Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, Kreu 3, e qasshme në: [FrameworkPocket_ALB_Dec2002.qxd \(kuvendikosoves.org\)](http://FrameworkPocket_ALB_Dec2002.qxd(kuvendikosoves.org))

16 Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme, Republika e Kosovës, ka një kornizë ligjore mjaft të konsoliduar në luftimin e dhunës në familje, sidomos pas plotësimeve në vitin e fundit, megjithatë ende mbetet hapësirë për plotësim. Është e rëndësishme të theksohet se Ligji nr.05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, i cili është në fuqi nga viti 2015, për shkak të mungesës së buxhetimit dhe planifikimit adekuat, nuk ka gjetur zbatim.¹⁷

Për më tepër, Republika e Kosovës duhet të adresoj edhe çështjen e Dhunës me Bazë Gjinore Online sepse kjo çështje është e adresuar pjesërisht, duke mos përmbajtur dispozita të posaçme për publikimin e paautorizuar të të dhënave personale (doxing), ngacmimin kibernetik (cyberstalking) dhe shpërndarjen e paautorizuar të imazheve personale, me theks të veçantë në kontekst gjinor.¹⁸ Përtej kësaj, institucionet e Kosovës përballen me kufizime të konsiderueshme sa i përket kësaj çështje për shkak të mungesës së trajnimeve të specializuara, mjeteve teknologjike dhe bashkëpunimit të duhur ndërinstytucional.¹⁹

Po ashtu sfidë mbetet edhe çështja e femicidit, e cila nuk është paraparë si vepër e posaçme penale në Kosovë.²⁰ Vrasjet me motive gjinore klasifikohen si vrasje të rënda mirëpo termi specifik "femicid" nuk përdoret në procedurat ligjore si dhe motivet me bazë gjinore shpesh neglizhohen nëpër procese gjyqësore.²¹

Andaj dispozitat e lartpërmendura që për viktimat e dhunës në familje përbëjnë "varkën shpëtimtare të lundrimit në ujërat e trazuar", mbeten për t'u interpretuar, plotësuar dhe zbatuar në mënyrën më të mirë të mundshme nga institucionet përgjegjëse. Ky zbatim duhet të vijojë me theks të veçantë në një bashkëpunim të mirëfilltë, për të mirën e përgjithshme dhe për çrënjosjen e këtij fenomeni kriminal.

(Konventa e Stambollit), neni 5, prg.2, e qasshme në: [CETS 210 - Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence](#)

17 Rina Kika, Analizë Tematike: Reagimi i Shtetit të Kosovës ndaj Femicidit: Kriminalizimi dhe Masat Tjera, fq. 20. Projekti JUST React. E qasshme në: [link to be inserted]

18 Dorjeta Rukiqi, Analizë Tematike: Vlerësimi i Kapaciteteve Institucionale për të Luftuar Dhunën me Bazë Gjinore Online në Kosovë, fq. 9. Projekti JUST React. E qasshme në: [link to be inserted]

19 Po aty, fq. 15.

20 Rina Kika, Analizë Tematike: Reagimi i Shtetit të Kosovës ndaj Femicidit: Kriminalizimi dhe Masat Tjera, fq. 9. Projekti JUST React. E qasshme në: [link to be inserted]

21 Po aty.

1. RAPORTIMI I RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË POLICINË E KOSOVËS

Policia e Kosovës përbën një ndër hallkat qendrore institucionale në parandalimin dhe luftimin e veprave të dhunës në familje dhe dhunës në bazë gjinore. Roli i saj përfshinë ofrimin e mbrojtjes ndaj viktimave, identifikimin e autorëve dhe sigurimin e ndjekjes penale në përputhje me ligjet në fuqi. Megjithatë, roli i këtij institucionit nuk kufizohet vetëm në reagimin e shpejtë apo ofrimin e ndihmës emergjente, por edhe në zbatimin e urdhërbrojtjeve të lëshuara nga gjykata si dhe koordinimin në mënyrë efektive me institucionet e tjera përgjegjëse.

Si pikënisje e vlerësimit të trajtimit institucional ndaj rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore do të jetë **vlerësimi i performancës** ndaj Policisë së Kosovës **për periudhën korrik 2023 – qershor 2024**. Ky kapitull do të përshijë shpërndarjen gjeografike të rasteve të raportuara, dinamikën gjinore, marrëdhëniet familjare ndërmjet të dyshuarve dhe viktimave dhe grupmoshat e përfshira.

1.1 Shpërndarja rajonale e rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës për dhunën në familje

Gjatë periudhës **korrik 2023 – qershor 2024**, në Policinë e Kosovës janë raportuar gjithsej **2,856 raste** të dhunës në familje, që përfaqëson një rritje prej **4.4% krahasuar me vitin e kaluar**, kur ishin raportuar **2,735 raste**.²² Ky trend në rritje mund të jetë tregues i një përhapje më të gjerë të dhunës në familje në të gjithë vendin në njërin anë, por edhe për ndërgjegjësim më të madh për raportimin e këtyre rasteve në anën tjetër.

Kur vështrohet numri i rasteve absolute²³, **Prishtina** përfaqëson numrin më të madh të raportimeve, me gjithsej **964 raste**. Ky rezultat është i pritshëm, duke pasur parasysh që Prishtina është kryeqyteti dhe rajoni me popullsinë më të madhe. Megjithatë, për të ofruar një vlerësim më të drejtë dhe të standardizuar që merr parasysh dallimet në numrin e popullsisë së rajoneve, do të përdoret shkalla e rasteve për **10,000 banorë**.²⁴ Në këtë formë, do të krahasojmë incidencën²⁵ e dhunës në familje në rajone të ndryshme në mënyrë më të barabartë. Vlen të theksohet se Kosova vitin e fundit ka qenë në proces të regjistrimit të popullsisë, andaj, të dhënat sa i përket numrit të popullsisë nëpër rajonet që janë objekt i këtij hulumtimi, janë të dhëna preliminare.²⁶

Mitrovica Veriore shënon incidencën më të lartë të rasteve të dhunës në familje për periudhën korrik 2023 – qershor 2024. Me një numër jashtëzakonisht të vogël të popullsisë, me **2,346 banorë**, kjo komunë karakterizohet me një incidencë prej **281.33 rastesh** për 10,000 banorë, më e larta krahasuar me rajonet tjera. Pas Mitrovicës Veriore rradhitet **rajoni i Pejës**, me

22 Trajtimi Institucional i Rasteve të Dhunës në Familje, korrik 2022 – qershor 2023, fq. 9, i qasshëm në: GLPS-Just-React-Annual-Report-Domestic-and-Gender-based-Violence-in-Kosovo.pdf

23 Rastet absolute përfshijnë numrin total të rasteve të raportuara për një periudhë të caktuar.

24 Për të vlerësuar shkallën e rasteve për 10,000 banorë, fillimisht ndajmë numrin total të rasteve të raportuara në një rajon me popullsinë e përgjithshme të atij rajoni, dhe më pas shumëzojmë rezultatin me 10,000. Kjo metodë na tregon sa raste ndodhin për çdo 10,000 banorë dhe na mundëson të krahasojmë rajone me popullsi të ndryshme në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

25 Incidenca në kontekstin juridik dhe kriminologjik i referohet frekuencës së rasteve të reja të një lloji specifik krimi, si dhuna në familje, që ndodhin brenda një popullsie të caktuar gjatë një periudhe kohore të përcaktuar.

26 Të dhënat preliminare të Regjistrimit të Popullsisë në Kosovë 2024, të qasshme në: Te dhënat (rks-gov.net)

gjithësej **43.80 raste** për 10,000 banorë. Peja ka një popullsi prej **82,661 banorësh** ndërsa për periudhën e raportimit ka pasur **362 raste** që reflekton një përhapje të dukshme të dhunës.

Prishtina me një popullsi prej **227,154 banorësh** dhe me **964 raste** të raportuara, ka gjithashtu një incidencë të lartë me **42.44 raste** për 10,000 banorë. Meqë Prishtina është kryeqytet, ky rezultat përveç që është tregues i numrit të madh të rasteve të raportuara, mund të jetë edhe si tregues i rritjes së ndërgjegjësimit në këtë rajon. **Gjilani**, me **82,824 banorë** dhe me **318 raste** ka një incidencë prej **38.37 rastesh** për 10,000 banorë. Ani pse popullsia e këtij rajoni është shumëfish më e vogël se e Prishtinës, diferenca në shkallën e incidencës midis tyre është **4.07 raste** për 10,000 banorë. Gjilani rradhitet menjëherë pas Prishtinës sa i përket numrit të rasteve të raportimit të dhunës në familje.

Mitrovica Jugore karakterizohet për një numër të lartë absolut duke pasur parasysh numrin e popullsisë që është **64,680** dhe **236 raste** mirëpo sa i përket incidencës qëndron më mirë sesa 4 rajonet paraprake, me **36.49 raste** për 10,000 banorë. Po ashtu **Gjakova** me **36.29 raste** për 10,000 banorë ka incidencë të ngjashme me Mitrovicën Jugore. Ndërsa, **Prizreni** dhe **Ferizaj**, ani me pse numër të popullsisë rradhitet menjëherë pas Prishtinës, karakterizohen me numrin më të ulët të rasteve të raportuara sa i përket dhunës në familje. Përkatësisht me **25.50 raste** dhe **22.68 raste** për 10,000 banorë.

Tabela 1. Shpërndarja rajonale e rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës për periudhën korrik 2023 - qershor 2024.

Rajoni	Numri i Rasteve të Raportuara	Popullsia e Rajonit	Shkalla për 10,000 Banorë
Mitrovica Veriore	66	2346	281.33
Peja	362	82661	43.8
Prishtina	964	227154	42.44
Gjilani	318	82824	38.37
Mitrovica Jugore	236	64680	36.49
Gjakova	196	54000	36.29
Prizreni	315	123000	25.5
Ferizaj	216	95000	22.68

Sipas këtyre të dhënave, fenomeni i dhunës në familje në Kosovë gjatë periudhës monitoruese tregon një përhapje të pabarabartë mes rajoneve, ku disa zona shfaqin një incidencë dukshëm më të lartë. Këto të dhëna përfaqësojnë hallkën e parë në vlerësimin e trajtimit institucional të rasteve të dhunës në familje. Për një vlerësim më të plotë, ky raport do të përfshijë gjithashtu analizën e dy institucioneve të tjera, të cilat përbëjnë pjesët kyçe të zinxhirit institucional për trajtimin e këtij fenomeni.


1.2. Aspekti gjinor në rastet e dhunës në familje

Të dhënat e siguruara nga Policia e Kosovës për periudhën korrik 2023 – qershor 2024 pasqyrojnë qartë aspektin gjinor të dhunës në familje, duke rezultuar në një diferencë mjaft të madhe sa i përket viktimave gra dhe burra. Nga **2,856 raste** të raportuara, **79%** e viktimave janë gra, ndërsa vetëm **21%** janë burra. Ky fenomen pasqyron jo vetëm problematikën e dhunës në familje, por edhe pabarazitë gjinore dhe rolet patriarkale në shoqërinë kosovare dhe përtej saj.

Kjo mund të dëshmohej përmes standardeve që janë vënë nga normat ndërkombëtare të dhunës më bazë gjinore. Sipas **Konventës së Stambollit**, dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi me bazë gjinore.²⁷ Ky fenomen përfshinë dhunën fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, dhe në Kosovë pasqyron situatën e ndjeshme të grave në marrëdhëniet familjare dhe shoqërore.

Në bazë të të dhënave të siguruara në Prishtinë, nga **964 raste** të raportuara, **81.8%** e viktimave janë gra. Ndërsa në vështrim të rajoneve të tjera, **Peja** ka një përqindje të viktimave gra prej **82.8%**, **Mitrovica Jugore** shënon **84.7%**. **Ferizaj** dhe **Prizreni**, ndonëse me përqindje më të ulëta të raportimeve të përgjithshme, gjithashtu pasqyrojnë një përqindje të lartë të viktimave femra, duke forcuar bindjen se dhuna ndaj grave, përkatësisht dhuna me bazë gjinore është më se e evidente në Kosovë. Dhuna në familje prekë gratë në mënyrë joproporcionale në krahasim me burrat. Ky është po ashtu një tregues i dominancës së sistemit patriarkal në Kosovë, pavarësisht se e drejta zakonore nuk përbën burim themelor të së drejtës.

Grafiku 1. Raporti gjinor mes personave të dyshuar, të arrestuar dhe viktimave të dhunës në familje gjatë periudhës korrik 2023 – qershor 2024



Nga **571 të arrestuar**, **92.55 janë burra** ndërsa **7.5% janë gra**, kurse sa i përket personave të **dyshuar 88% janë burra** ndërsa **12% janë gra**. Si konkludim i këtyre rezultateve është se autorët e dhunës janë kryesisht burrat, një tregues i dominancës së sistemit patriarkal në Kosovë

²⁷ Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), Neni 1, e qasshme në: [Convention Albanian version \(coe.int\)](https://www.coe.int/t/e/treaties/Convention_Albanian_version.aspx)

pavarësisht se e drejta zakonore nuk përben burim themelor të së drejtës, tash e disa dekada Epilogu i këtyre të dhënave mund të ketë zgjidhje në rekomandimin e Konventës së Stambollit, e cila thekson nevojën për të ndërmarrë masat e nevojshme me qëllim të promovimit të ndryshimeve në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave me qëllim të ç'rrënjësjes së zakoneve dhe praktikave tjera që bazohen në idenë e inferioritet të grave apo edhe në rolet e stereotipizuara.²⁸

Vlen të theksohet se **ligji i ri**, bazohet në standardet e **Konventës së Stambollit** dhe ofron mekanizma më të fuqishëm për mbrojtjen e grave dhe ndjekjen penale të autorëve²⁹. Ky ligj përveç tjerash, thekson rëndësinë që kanë **urdhrat mbrojtës** në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Andaj, me qëllim të reflektimit të gjendjes, nga të dhënat e siguruar kemi gjetur se për periudhën e monitorimit **janë arrestuar gjithsej 28 persona për mosrespektim të urdhërmbrojtjes**, që përbën **4.9 % të të arrestuarve për rastet e dhunës në familje**.

Përveç grave si viktime të drejtpërdrejta, edhe **fëmijët** janë shpesh **viktime indirekte**, pasi ata shpesh përjetojnë dhunën në aspektin psikologjik duke qenë dëshmitarë të saj. Kjo krijon pasoja të mëdha për mirëqenien e tyre, megjithatë mbetet sfida trajtimi i tyre në mënyrë të duhur nga institucionet përgjegjëse. Në këtë kuadër, **Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026** synon të rrisë ndërgjegjësimin publik dhe të përmirësojë mbështetjen institucionale, duke përfshirë edhe fëmijët e prekur nga ky fenomen.³⁰

1.3. Roli i marrëdhënieve familjare në dinamikën e dhunës në familje

Të dhënat e siguruar nga Policia e Kosovës për periudhën korrik 2023 – qershor 2024 tregojnë një portret të dinamikave të dhunës brenda marrëdhënieve familjare. Nga **2,856 raste** të raportuara, **757** ose rreth **26.5%** përfshijnë bashkëshortët si autorë të dhunës. Ky numër tregon se përqindja më e madhe e dhunës së raportuar ndodh në kontekstin e marrëdhënieve bashkëshortore, fakt i provuar tashmë edhe në aspektin ndërkombëtar ku **dhuna ndaj partnerëve intimë është forma më e zakonshme e dhunës me bazë gjinore**. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, rreth 1 në 3 gra (30%) përjetojnë dhunë fizike ose seksuale nga partneri intim gjatë jetës së tyre.³¹

Përveç bashkëshortëve, **27 raste** ose rreth **0.9%** përfshijnë prindërit si autorë të dhunës në familje, ndërsa **46 raste** ose **1.6%** përfshijnë dhunë mes vëllezërve dhe motrave. Raste të përfshirjes së fëmijëve si autorë janë më të rralla, me **15 raste** ose **0.5%**. Ndërkohë, kategoria "tjetër" e cila përfshinë anëtarë të tjerë të familjes ose persona të tjerë të lidhur me viktimën, përfshinë **2,095 raste** ose **73.3%**. Pra, dhuna në familje pavarësisht se ka një trend më të theksuar të paraqitjes në raportet bashkëshortore, megjithatë është prezente edhe në mes të anëtarëve të tjerë të familjes.

Të dhënat e përshkruara më sipër pasqyrojnë një realitet kompleks dhe shqetësues, ku viktimat e dhunës në familje shpesh janë të lidhura ngushtë me autorët, jo vetëm emocionalisht, por në raste të caktuara edhe sa i përket vendimeve të përbashkëta ekonomike si dhe strehimit.

28 Po aty, Neni 12.

29 Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (2023)

30 Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026, fq. 5, e qasshme në: [ALB-Strategjia-Kombëtare-për-Mbrojtje-nga-Dhuna-në-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022---2026.pdf](#)

31 [Violence against women \(who.int\)](#)

Kjo situatë rezulton edhe në hezitim nga ana e viktimave të dhunës në familje për zgjidhje adekuate, duke i "amnistuar" autorët e në anën tjetër duke cenuar të drejtat e tyre themelore. Prandaj, krijimi dhe funksionalizimi i programeve mbështetëse për viktimat nuk është thjesht i domosdoshëm, por kritik për të siguruar mbrojtjen e tyre dhe për të luftuar në mënyrë efektive këtë fenomen të dhimbshëm në shoqërinë tonë. Zbatimi i qëndrueshëm i këtyre masave do të ndihmojë në çrrënjosjen e kësaj dukurie kriminale.

1.4. Analiza demografike e viktimave dhe të dyshuarve të dhunës në familje

Ky raport përveç tjerash, do të trajtojë edhe shpërndarjen e dhunës në familje sipas grupmoshave, duke përfshirë si viktimat ashtu edhe autorët. Këto të dhëna do të identifikojnë grupet më të prekura si dhe ata që kanë më shume gjasa të jenë autorë të dhunës, duke shërbyer si indicie kyçe për të arritur në konkluzione mbi natyrën e fenomenit dhe për të mbështetur hartimin e politikave dhe strategjive efektive në parandalimin dhe trajtimin e dhunës në familje.


Për periudhën korrik 2023-qershor 2024, në total janë regjistruar **2,940 viktima** të dhunës në familje, të ndara sipas moshës si në vijim: Grupmoshat më të prekura si për viktimat ashtu edhe për autorët janë midis **20-40 vjeç**, një periudhë e jetës që zakonisht karakterizohet nga sfida të ndryshme personale, sociale dhe familjare.³² Viktimat dhe autorët në këtë grupmoshë përbëjnë shumicën dërrmuese të rasteve të dhunës në familje.

Grupi më i madh i **viktimave** është ai i moshës **30-40 vjeç**, që përfaqëson **25.4%** të totalit, ndërsa viktimat midis moshave **20-30 vjeç** përbëjnë **22.7%**. Po ashtu të dhënat për **të dyshuarit** ndjekin një trend të ngjashëm, me grupmoshën **20-30 vjeç** që përbën **26.6%** dhe grupmoshën **30-40 vjeç** që përbën **26.1%** të të dyshuarve. Ndërsa, sa i përket të arrestuarve, **27%** përfshinë grupmoshat **30-40 vjeç** dhe **26%** grupmoshat **20-30 vjeç**.

Këto të dhëna pasqyrojnë domosdoshmërinë e adresimit të sfidave potenciale që karakterizojnë këto grupmosha, të cilat, pavarësisht rrethanave specifike të çdo rasti, mund të ndajnë disa karakteristika të përbashkëta.

32 Arnett, J.J., 2000, Emerging Adulthood: A Theory of Development from the Late Teens Through the Twenties

Grafiku 2. Pasqyra e grupmoshave për viktimat, të dyshuarit dhe të arrestuarit.



II. TRAJTIMI I RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE NGA PROKURORI I SHTETIT

Prokurori i Shtetit (tutje: Prokuroria) ka një rol kyç në adresimin e dhunës në familje në Kosovë, duke hetuar, ngritur aktakuza dhe ndjekur penalisht kryerësit e veprave. Ky kapitull shqyrton performancën e Prokurorisë Themelore gjatë **periudhës korrik 2023 – qershor 2024**, duke analizuar të dhënat e kallëzimeve penale dhe aktakuzave për dhunën në familje. Kjo analizë nxjerr në pah aftësitë e Prokurorisë për të trajtuar ngarkesën e lartë të rasteve, si dhe sfidat e mbetura për të përmirësuar kapacitetet dhe koherencën institucionale në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Në këtë kapitull, gjithashtu vlerësohen treguesit rajonal për shpërndarjen e aktakuzave, duke siguruar një pasqyrë të qartë mbi efektivitetin e secilit rajon.

Në përpjekjet tona për të trajtuar aspektin gjinor të përfshirjes së të akuzuarve dhe viktimave, është vënë re se Prokuroria nuk disponon të dhëna përkatëse. Kjo nënvizon nevojën për bashkëpunim ndër-institucional në krijimin e një databaze të përbashkët, me qëllim përcaktimin e treguesve të unifikuar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe identifikimin e çështjeve më të rëndësishme në këtë drejtim. Një shembull i suksesshëm është Spanja, e cila ka zhvilluar "Sistemin Integral të Monitorimit të Dhunës Gjinore (VioGén)", që mbledh të dhëna nga policia, gjykatat, prokuroria dhe institucionet sociale për dhunën me bazë gjinore.³³

2.1 Kallëzimet Penale dhe Ngritja e Aktakuzave: Nisma për Drejtësi dhe Mbrojtje

Kallëzimet penale paraqesin instrumentin kryesor në identifikimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, kjo sepse përbëjnë bazën për veprimet ligjore të mëvonshme nga prokuroria dhe gjykatat. Me fokus tek pesha e këtyre veprave penale, kallëzimet penale kanë rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe institucioneve mbi përmasat e këtij fenomeni kjo sepse ky instrument përbën hapin e parë që nxitë procedurat ligjore të hetimit dhe ndjekjes penale ndaj autorëve të këtyre veprave. Për më tepër, ofrojnë siguri për viktimat sepse mund të përfitojnë nga masat mbrojtëse siç është urdhërmbrojtja, ndihma nga qendrat sociale dhe mbështetje psikologjike e ligjore.

Për periudhën **korrik 2023 – qershor 2024**, Prokurori i Shtetit ka raportuar gjithsej **2,815 kallëzime penale** për dhunën në familje të pranuar në të gjithë vendin, shifër që përfaqëson një numër mjaft të madh të raportimeve.³⁴ Megjithatë, për periudhën korrik 2022 – qershor 2023, Prokuroria ka raportuar gjithsej **3169 kallëzime penale**³⁵ me një diferencë prej **354 rastesh** më pak për këtë cikël monitorues, që për këtë fenomen kriminal është diferencë gati se e papërfillshme.

Për periudhën raportuese, Prokuroria nga **2,815 kallëzime penale** ka ngritur **2,635 aktakuza** për veprat penale të dhunës në familje, duke arritur kështu në një shkallë të

33 Komisioni Evropian. "VioGén 5.0: Zbulimi i Sistemit të Vlerësimit të Rrezikut për Dhunën me Bazë Gjinore në Spanjë." VioGen 5.0: discovering Spain's risk assessment system of gender-based violence | Interoperable Europe Portal. Qasur më 30.10.2024.

34 Të dhënat e pranuar nga Zyra për Komunikim e KPK-së, me datë 31 korrik dhe 28 tetor 2024.

35 Trajtimi Institucional i Rasteve të Dhunës në Familje, korrik 2022 – qershor 2023, fq. 13, i qasshëm në: GLPS-Just-React-Annual-Report-Domestic-and-Gender-based-Violence-in-Kosovo.pdf

lartë aktakuzash me rreth **93.6%**. Kjo dëshmon se Prokuroria ka shqyrtuar të gjitha të dhënat dhe provat e paraqitura mbi bazën e kallëzimeve penale, duke vendosur që në një pjesë të madhe të rasteve të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm procedural.

2.1.1. Ndarja rajonale e aktakuzave për dhunën në familje

Përveç raportit mes kallëzimeve penale me aktakuzat raporti analizon edhe raportin rajonal të shpërndarjes së aktakuzave për veprat penale të dhunës në familje nëpër rajonet e Kosovës. Me qëllim të ofrimit të një vlerësimi të standardizuar, raporti përdorë metodologjinë e njëjtë sikurse në kapitullin që trajton shpërndarjen rajonale të rasteve të raportuara të dhunës në familje në Policinë e Kosovës, duke llogaritur shkallën e aktakuzave për **10,000 banorë** në secilin rajon, varësisht nga popullsia e secilit rajon.


Rajoni i **Pejës** paraqitet me incidencën më të lartë të aktakuzave për 10,000 banorë me **79.62**, që përbën pothuajse dyfishin e incidencës së rasteve të raportuara në Polici, 43.80 raste. Më tejherë pas Pejës, rradhitet rajoni i **Prishtinës** që mban një incidencë të ngjashme mes asaj në Polici dhe në Prokurori, me 42,44 raste të raportuara në Polici dhe **41.47** aktakuza të ngritura nga Prokuroria për 10,000 banorë. Ky rezultat pasqyron një koherencë më të lartë në mes të raportimit si dhe ndjekjes penale. **Gjilani** me një incidencë prej 38.37 të raportuar në Polici dhe **27.28** për aktakuzat e ngritura, tregon një shkallë të lartë të raportimit të dhunës në familje dhe ndjekje penale relativisht më të ulët nga Prokuroria. Ndërsa **Mitrovica** ka një incidencë prej **21.33** aktakuzash për 10,000 banorë, duke u vlerësuar kështu në nivel mesatar të ndjekjes penale për rastet e dhunës në familje. Vlen të theksohet se sa i përket aktakuzave, Mitrovica nuk është vlerësuar si e ndarë në dy zona (Jug dhe Veri) andaj incidenca është vlerësuar për 67,026 banorë. **Gjakova** ka një incidencë të raportimeve në Polici prej 36.29 ndërsa sa i përket aktakuzave **17.13**. Kjo diferencë mund të jetë tregues i sfidave potenciale që mund të ketë ky rajon në shqyrtimin e provave dhe fakteve të ofruara përmes kallëzimeve penale, megjithatë mund të jetë edhe si tregues i hudhjes poshtë të kallëzimeve penale në mungesë të provave. **Prizreni dhe Ferizaj** paraqiten si rajonet me incidencat më të ulëta edhe sa i përket Policisë por edhe Prokurorisë të shprehur në aktakuza, që reflekton për nivel të ulët të raportimit në këto rajone apo edhe skenari më i mirë që mund të jetë nivel i ulët i rasteve të dhunës në familje.

Tabela 2. Ndarja rajonale e aktakuzave për dhunën në familjegjatë periudhës korrik 2023 – qershor 2024

Rajoni	Incidenca e Aktakuzave për 10,000 Banorë	Numri i Aktakuzave	Popullsia
Peja	79.62	658	82,661
Prishtinë	41.47	942	227,154
Gjilani	27.28	226	82,824
Mitrovicë	21.33	143	67,026
Prizreni	18.95	337	177,781
Gjakovë	17.13	162	94,556
Ferizaj	15.38	167	108,610

2.2. Vlerësimi i performancës së Prokurorit të Shtetit në rastet e dhunës në familje: Efikasiteti dhe Sfidat

Pjesë e këtij kapitulli është edhe matja e performancës së këtij institucioni për periudhën e monitorimit, përmes të dhënave të siguruar nga Zyra e Statistikave të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) si dhe gërshetimit të këtyre të dhënave me metodologjinë CEPEJ.³⁶ CEPEJ përdor tregues të tillë si **Norma e Zgjidhjes së Lëndëve (Clearance Rate %)**, **Norma e Qarkullimit të Lëndëve (Case Turnover Ratio)**, dhe **Koha e Zgjidhjes së Lëndëve (Disposition Time)**. Sipas të dhënave të siguruar numri i lëndëve të reja/ të pranuar është 2,815, sa i përket lëndëve të zgjidhura 2,889 ndërsa lëndë të pazgjidhura gjithsej 1,035.



Lëndet e pranuar
2,815



Lëndet e zgjidhura
2,889



Lëndet e pazgjidhura
1,035

- Norma e Trajtitit³⁷ të Lëndëve (Clearance Rate %)

Norma e Trajtitit të Lëndëve (Clearance Rate %) për Prokurorinë do të llogaritet si raporti ndërmjet numrit të lëndëve të zgjidhura dhe lëndëve të reja të pranuar gjatë periudhës raportuese. Kjo përqindje reflekton kapacitetin e prokurorive themelore për të trajtuar rastet e reja dhe për të ulur ngarkesën e lëndëve të pazgjidhura. Ky tregues reflekton kapacitetin e prokurorive për të trajtuar rastet e reja dhe për të ulur ngarkesën e lëndëve të pazgjidhura.

Norma prej **102.6%** regon se Prokuroria ka zgjidhur më shumë lëndë sesa janë pranuar gjatë periudhës raportuese. Duke e krahasuar me profilet e 48 vendeve të ndryshme³⁸, kjo normë është tregues se përtej ngarkesës ekzistuese, fluksi i ri i lëndëve është trajtuar suksesshëm.

- Norma e Qarkullimit të Lëndëve (Case Turnover Ratio)

Norma e Qarkullimit të Lëndëve (Case Turnover Ratio) llogaritet përmes raportit mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëve të pazgjidhura brenda një viti. Kjo normë tregon aftësitë e këtij institucioni për të përballuar dhe zgjidhur ngarkesën totale të rasteve, përfshirë edhe ato të pazgjidhura nga periudhat e mëparshme. Në bazë të të dhënave të siguruar nga KPK, Norma e Qarkullimit të Lëndëve (tutje: NQL) për periudhën raportuese është 2.7, që vlerësohet të jete normë mjaft e lartë e qarkullimit të lëndëve³⁹. Kjo nënkupton se Prokuroria ka zgjidhur **2.7 herë më shumë lëndë** sesa numri i lëndëve të pazgjidhura. Pra, Prokuroria po zgjidh më shumë lëndë sesa mbeten të pazgjidhura, duke reduktuar numrin e lëndëve në pritje.

36 Udhëzimet e CEPEJ, e qasshme në: CEPEJ-GT-EVAL

37 Në vend të shprehjes zgjidhje do të përdoret termi trajtim, sepse Prokuroritë nuk marrin vendime përfundimtare.

38 Këshilli i Evropës. "Sistemet gjyqësore evropiane Raporti i vlerësimit të CEPEJ". I qasshëm në: 1680b21e99

39 Këshilli i Evropës. Metodologjia CEPEJ. "Measuring the quality of justice", prg.39. I qasshëm në: rm.coe.int/1680747548#_ftn7

Kohëzgjatja e Trajtimin të Lëndëve (Disposition Time)

Kohëzgjatja e Trajtimin të Lëndëve (Disposition Time) konsiderohet si një ndër treguesit më të rëndësishëm në vlerësimin e performancës së sistemit të drejtësisë.⁴⁰ Ky tregues llogaritet përmes 365 ditëve që përbëjnë periudhën raportuese në raport me normën e qarkullimit të lëndëve të prokurorive themelore. Kohëzgjatja e Trajtimin të Lëndëve (tutje: KTL) nga ana e prokurorive themelore është **131 ditë** që tregon se Prokuroria po trajton lëndët me një shpejtësi të krahasueshme me praktikën më të mira evropiane.

Si përfundim, mund të themi se, në bazë të rezultateve, Prokuroria e Shtetit ka **treguar rezultate pozitive** sa i përket efikasitetit të lartë në trajtimin e rasteve. Mirëpo, numri i madh i këtyre rasteve dhe pasojat e pariparueshme janë tregues shqetësues për vendin tonë. Andaj, kjo sugjeron se përtej matjes së performancës institucionale, ekziston një boshllëk në parandalimin dhe adresimin rrënjësor të këtij fenomeni kriminal.

40 Po aty, prg.41. I qasshëm në: rm.coe.int/1680747548#_ftn7

III. TRAJTIMI I RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJË NGA GJYKATAT THEMELORE NË KOSOVË


Ky kapitull synon të analizojë efikasitetin dhe efektivitetin e gjykatave në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Fillimisht, theksi vihet në analizimin e të dhënave përmes të dhënave të ofruara nga Zyra për Informim dhe Komunikim me Media në KGJK⁴¹, më pas përmes shqyrtimit të të dhënave nga mostra të aktgjykimeve të siguruara në webfaqen e KGJK-së, gjithashtu, përmes organizimit të një fokus grupi që ofron informacione të drejtpërdrejta nga terreni.

Ky kapitull ka për qëllim të paraqesë një pasqyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse të mënyrës se si trajtohen rastet e dhunës në familje, të identifikojë sfidat e sistemit gjyqësor dhe të sugjerojë përmirësime për rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë në këto raste kritike.

3.1. Vlerësimi i performancës së Gjykatave Themelore në rastet e dhunës në familje

Ky kapitull synon të analizojë dhe të reflektojë të dhëna kualitative dhe kuantitative sa i përket efikasitetit të sistemit gjyqësor në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, përkatësisht fokusi do të jetë tek gjykatat themelore. Kjo arrihet përmes të dhënave të siguruara përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare. Për vlerësimin e performancës së këtij institucioni do të përdoren treguesit e përcaktuar në metodologjinë e CEPEJ⁴², si: **Norma e Zgjidhjes së Lëndëve (Clearance Rate %)**, **Norma e Qarkullimit të Lëndëve (Case Turnover Ratio)** dhe **Kohëzgjatja e Zgjidhjes së Lëndëve (Disposition Time)**. Për më tepër, KGJK, ka miratuar Planin Strategjik të Teknologjisë Informative 2024 -2029 për implementimin e mjeteve të drejtësisë digjitale të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).⁴³

Bazuar në të dhënat për periudhën **korrik 2023 – qershor 2024**, gjykatat kanë pranuar gjithsej **1,145 raste** të klasifikuara si dhunë në familje. Nga këto raste të pranuar, **408 janë zgjidhur**, ndërsa totali i rasteve të zgjidhura për periudhën raportuese arrin në **856**, përfshirë këtu edhe raste të tjera të pranuar para periudhës raportuese, duke treguar se **737 raste** mbeten ende të pazgjidhura. Për më tepër, **74 raste** janë apeluar përmes përdorimit të mjeteve procedurale juridike.



Raste të pranuar
1,145



Raste të zgjidhura
856



Raste të pazgjidhura
737

41 Të dhënat e pranuar nga Zyra për Informim dhe Komunikim me Media në KGJK, me datë 13 mars dhe 28 tetor 2024.

42 Udhëzimet e CEPEJ, e qasshme në: [1680788300](https://www.cebepj.org/en/cepej-guidelines)

43 Plani Strategjik i IT i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i qasshëm në: [13969_KJC_IT_Strategic_Plan_of_the_Kosovo_Judicial_Council_2024_2029.pdf](https://www.kgjk.com.mk/Portals/0/13969_KJC_IT_Strategic_Plan_of_the_Kosovo_Judicial_Council_2024_2029.pdf)

Norma e Zgjdhjes së Lëndëve (Clearance Rate %)

Norma e Zgjdhjes së Lëndëve (Clearance Rate %) përkufizohet si raporti në mes të lëndëve të zgjidhura ndaj lëndëve të reja të pranuar, i shumëzuar me 100, për të përfutur përqindjen e kapacitetit të punës së gjykatave themelore në Kosovë për periudhën raportuese. Në këtë periudhë raportuese Norma e Zgjdhjes së Lëndëve (tutje: NZL) në Kosovë është **74.7%**, një rezultat që reflekton se gjykatat po përballen me sfida në menaxhimin efektiv të lëndëve.⁴⁴ Pra, numri i lëndëve të reja të pranuar është më i madh sesa numri i lëndëve të zgjidhura, duke treguar se numri i lëndëve të pazgjidhura është në rritje.

Norma e Qarkullimit të Lëndëve (Case Turnover Ratio)

Norma e Qarkullimit të Lëndëve (Case Turnover Ratio) përkufizohet si raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe lëndëve të pazgjidhura gjatë periudhë të caktuar. Kjo normë mat aftësinë e sistemit për të përballuar dhe zgjidhur ngarkesën totale të lëndëve, përfshirë ato të pazgjidhura nga periudhat e mëparshme. Sipas kësaj formule, Norma e Qarkullimit të Lëndëve (tutje: NQL) në Kosovë për periudhën raportuese është **1.39** që për dallim nga norma e zgjidhjes së lëndëve vlerësohet pozitivisht.⁴⁵

Në shikim të parë ky rezultat mund të duket kontradiktor në raport me NZL mirëpo janë tregues të ndryshëm sepse vlera e NZL prej 74.7% është tregues se gjykatat po hasin në vështirësi në përballimin e fluksit të ri të lëndëve. Ndërsa, vlera e NQL prej 1.39 është tregues se krahasuar me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës, gjykatat zgjidhin një numër të konsiderueshëm lëndësh, duke mbajtur numrin e lëndëve të pazgjidhura relativisht të ulët. Pra, NZL matë aftësinë e institucionit për të përballuar fluksin e lëndëve të reja ndërsa NQL matë raportin ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe të lëndëve të pazgjidhura.

Kohëzgjatja e Zgjdhjes së Lëndëve (Disposition Time)

Kohëzgjatja e Zgjdhjes së Lëndëve (Disposition Time) përkufizohet si raporti ndërmjet 364 ditëve dhe normës së qarkullimit të lëndëve. Ky tregues reflekton numrin mesatar të ditëve të nevojshme për të përfunduar një lëndë, duke pasqyruar efikasitetin kohor të gjykatave themelore. Sipas analizës së të dhënave, janë nevojitur përafërsisht **262 ditë** që të zgjidhen lëndët për periudhën raportuese. Kohëzgjatja e Zgjdhjes së Lëndëve (KLZ) për gjykatat në Kosovë është tregues se lëndët po marrin më shumë kohë për t'u zgjidhur në krahasim me standardet evropiane.⁴⁶ Ky rezultat reflekton nevojën për punë të vazhdueshme në aspekt të menaxhimit të lëndëve por edhe të burimeve njerëzore.

44 Këshilli i Evropës. "Sistemet gjyqësore evropiane Raporti i vlerësimit të CEPEJ". I qasshëm në: 1680b21e99

45 Këshilli i Evropës. Metodologjia CEPEJ. "Measuring the quality of justice", prg.39. I qasshëm në: rm.coe.int/1680747548#_ftn7

46 Këshilli i Evropës. "Sistemet gjyqësore evropiane Raporti i vlerësimit të CEPEJ". Fq.113. I qasshëm në: 1680b1e91d

3.1.1. Përmbledhja e verdikteve finale mbi rastet e dhunës në familje nga ana e Gjykatave Themelore në Kosovë

Në periudhën raportuese, nga gjithësej **856 lëndë të zgjidhura**, **701 raste** kanë rezultuar të kenë aktgjykime me **dënime fajësuese**, duke e vënë në pah kështu angazhimin e gjyqësorit për të ndëshkuar kryerësit e veprave penale të dhunës në familje. Nga këto vendime:

297 raste kanë përfunduar me **dënime me kusht**, një nga llojet më të zakonshme të ndëshkimeve.

72 raste përfshijnë kombinimin e **dënimeve me kusht me gjoba apo urdhra për trajtim të detyrueshëm rehabilitues**.

Ndërsa, **94 raste** janë ndëshkuar me **dënim me burgim**, duke përfshirë masën e burgimit në rastet më të rënda ose të përsëritura.

Duke u bazuar në të dhënat e siguruara mund të themi se vërehet angazhimi për përballimin e fluksit të lëndëve. Megjithatë periudha e zgjatur për zgjidhjen e rasteve dhe përdorimi i kufizuar i dënimeve më të rënda, siç janë dënimet me burgim, pasqyrojnë nevojën për përmirësim të mëtejshëm. Në këtë drejtim, një harmonizim në mes të ndëshkimit por edhe rehabilitimit, së bashku me rritjen e kapaciteteve njerëzore, janë të domosdoshme në adresimin më adekuat të çështjeve të dhunës në familje, duke e forcuar më tej besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor.

3.2. Vendimet gjyqësore në Rastet e Dhunës në Familje: Një Analizë e Thelluar e Mostrës

Si pjesë përbërëse e këtij kapitulli janë edhe disa aktgjykime të lëshuara nga gjykatat e shkallës së parë në Kosovë. Këto aktgjykime paraqesin një pasqyrë më të thuktë se si rastet e dhunës në familje trajtohen në sistemin gjyqësor të Kosovës, përfshirë këtu politikën ndëshkimore, gjendjen ekonomike të viktimave dhe të akuzuarve si dhe aspektet gjinore dhe dinamiken e recidivizmit.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se një numër i konsiderueshëm i aktgjykimeve janë fshirë nga faqet zyrtare të institucioneve përkatëse për shkak të ndjeshmërisë së rasteve të dhunës në familje. Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka kërkuar qasje në dokumente publike me qëllim të analizimit të të gjitha aktgjykimeve për periudhën e monitorimit, por kemi pranuar vendim refuzues.⁴⁷


Ky refuzim bazohet në **Udhëzimin Administrativ nr. 01/2021**, për Plotësimin dhe Ndryshimin e **Udhëzimit Administrativ nr. 04/2019** për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, konkretisht në nenin 2B, i cili përcakton “kufizimin e publikimit të aktvendimeve meritore të gjykatave themelore”. Në paragrafin 1, pika 1.7 e këtij udhëzimi theksohet se gjykatat themelore duhet të publikojnë të gjitha aktvendimet meritore, *me përjashtim të atyre që lidhen me rastet e dhunës në familje*.

47 Vendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, QDP.nr.8/24, i datës 21.05.2024

Gjithsej janë trajtuar **57 aktgjykime**⁴⁸ si mostër për nevojat e këtij hulumtimi. Në kuadër të këtij nënkapitulli, do të trajtohen disa tregues që janë parapërcaktuar për të vlerësuar efektivitetin e gjykatave në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Këta indikatorë i kontribuojnë krijimit të një pamje më të qartë mbi trajtimin institucional të këtyre rasteve dhe sfidat e mundshme në këtë drejtim.

Duke u bazuar në aktgjykimet e publikuara, del qartë se **Prishtina** dominon me **23 raste të publikuara**, një numër që tejkalon ndjeshëm rajonet e tjera. **Mitrovica** e pason Prishtinën me **12 raste** si dhe **Prizreni** me **10 raste**. Ndërsa në **Pejë** janë trajtuar **7 raste**, e **Gjilani dhe Gjakova** paraqiten me numrin më të ulët të aktgjykimeve, me përkatësisht **3 dhe 2 raste**.

Grafiku 3. Ndarja rajonale e aktgjykimeve



3.2.1. Kohëzgjatja e procedurës

Në kuadër të trajtimit të të gjitha aktgjykimeve, kemi trajtuar edhe **kohëzgjatjen e procedurës**, gjegjësisht periudhën nga ngritja e aktakuzës e deri tek shpallja e aktgjykimet. Në secilin rast, kohëzgjatja e procedurave u mat duke llogaritur diferencën mes datës së aktgjykimit dhe datës së ngritjes së aktakuzës. **Mesatarja e kohëzgjatjes** për këto raste rezultoi të jetë **141 ditë (përafërsisht 5 muaj)**, me një **maksimum prej 799 ditësh (pak më shumë se dy vite)** dhe një **minimum prej vetëm katër ditësh**. Këto rezultate tregojnë një ndryshueshmëri të madhe në trajtimin e rasteve, gjë që mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e viktimave dhe qasjen e tyre në drejtësi. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se nga numri total i aktgjykimeve të analizuara, kemi vetëm një **aktgjykim refuzues**, procedura gjyqësore e të cilit ka zgjatur gjithësej

48 Aktgjykimet e analizuara janë të qasshme në: <https://www.gjyqesori-rks.org/aktgjykimet/> me numër të rastit: 2023:160133, P.nr.530/22, 2023:130360, P.nr.158/23, P.nr.711/22, P.nr.847/2023, P.nr.58/2022, P.nr.401/2023, P.nr.349/2023, P.nr.333/23, P.nr.5/2024, P.nr.145/2023, P.nr.379/23, P.nr.172/23, P.nr.218/23, P.nr.1032/22, P.nr.918/23, P.nr.237/2023, P.nr.26/2023, P.nr.3697/21, P.nr.354/23, P.nr.358/23, P.nr.373/22, P.nr.2585/23, P.nr.331/23, P.nr.375/23, P.nr.411/23, P.nr.216/23, P.nr.2742/23, P.nr.2890/23, P.nr.454/23, P.nr.404/23, P.nr.406/23, P.nr.337/23, P.nr.405/23, P.nr.279/23, P.nr.413/23, P.nr.79/23, P.nr.479/23, P.nr.362/23, P.nr.1358/2022, P.nr.198/2023, P.nr.677/23, P.nr.870/21, P.nr.161/23, P.nr.54/23, P.nr.732/22, P.nr.290/23, P.nr.419/23, P.nr.189/23, P.nr.244/23, 2022:249494, 2022:238323, 2022:190980, 2023:010907, P.nr.124/22, P.nr.252/21, P.nr.740/21.

693 ditë, ndërsa **56 aktgjykime tjera kanë qenë dënuese**. Kjo është gjetje pozitive në dritën e politikës së ashpërsuar ndëshkimore, meqë shumica dërmuese e aktgjykimeve janë aktgjykime dënuese. Ndërsa sa i përket **mesatares së kohëzgjatjes së procedurave të aktgjykimeve dënuese**, ajo rezulton të jetë **131 ditë**.

Bazuar në të dhënat e siguruar nga aktgjykimet, kemi krijuar një pasqyrë të dallimeve në **kohëzgjatjen e procedurave sipas rajoneve. Peja** shënon kohëzgjatjen më të gjatë të procedurave, me një **mesatare prej 364 ditësh** dhe një **maksimum prej 799 ditësh**. Në anën tjetër, Prishtina ka numrin më të madh të lëndëve të analizuara, gjithsej **23 raste**, por një kohëzgjatje mesatare relativisht më të shkurtër prej **92 ditësh**. Ndërsa, **Gjakova** rezulton me kohëzgjatjen më të shkurtër mesatare prej **88 ditësh** në zgjidhjen e rasteve të dhunës në familje.

Tabela 3. Kohëzgjatja e procedurave në nivel rajonal.

Rajoni	Numri i lëndëve	Kohëzgjatja mesatare	Kohëzgjatja maksimale	Kohëzgjatja minimale
Prishtina	23	92 ditë	570 ditë	8 ditë
Mitrovica	12	98 ditë	353 ditë	13 ditë
Prizreni	10	153 ditë	378 ditë	41 ditë
Peja	7	364 ditë	799 ditë	105 ditë
Gjilani	13	160 ditë	343 ditë	9 ditë
Gjakova	2	88 ditë	91 ditë	84 ditë

3.2.1.1. Lloji i dhunës

Në analizën e 57 aktgjykimeve të trajtuara nga gjykatat e shkallës së parë për dhunën në familje, fokus do t'i ipet edhe **llojit të dhunës**.

Në bazë të aktgjykimeve të siguruar, dhuna në familje paraqitet në katër forma kryesore, si më poshtë:

1. Dhunë fizike dhe psikologjike

- Numri i rasteve: **9 (nëntë) raste**

2. Dhunë kumulative (fizike, psikologjike dhe ekonomike)


- Numri i rasteve: **1 (një) rast**

3. Dhunë fizike

- Numri i rasteve: **17 (shtatëmbëdhjetë) raste**

4. Dhunë psikologjike

- Numri i rasteve: **30 (tridhjetë) raste**

Grafiku 4. Numri i rasteve dhe lloji i dhunës.

Sipas rezultateve, dhuna psikologjike është lloji më i shpeshtë i dhunës në familje, ky është tregues i rritjes së ndërjegjësimit edhe e palëve të dëmtuara për të raportuar këtë lloj të dhunës. Po ashtu kemi një rast specifik ku kumulativisht është cilësuar si dhunë fizike, psikologjike dhe ekonomike. Fatmirësisht, Republika e Kosovës me ndryshimet e fundit në Ligjin e ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, për herë të parë e përfshinë në mënyrë të qartë dhunën ekonomike si një formë të pavarur të dhunës në familje.⁴⁹

3.2.1.2. Aspekti gjinor dhe raporti mes palëve procedurale

Sa i përket **aspektit gjinor**, në total janë **62 të akuzuar** ndërsa **75 viktima**, në mesin e këtyre janë **56 raste (75% e rasteve)** ku gratë janë viktima, **17 burra (23% e rasteve)** ndërsa **53 raste (85% e rasteve)** kur burrat janë të akuzuar dhe **9 raste (15% e rasteve)** gratë. Nga mostrat mund të konkludojmë se janë **5 raste (9% e rasteve)** në të cilat pala e akuzuar dhe viktima janë burra, ndërsa janë **38 raste (67% e rasteve)** ku si të akuzuar paraqiten burrat ndërsa viktimat janë gratë. Si dhe, **4 raste (7% e rasteve)** ku është një burrë dhe një grua viktima. Në **një rast (2% e rasteve)** na paraqiten 2 viktima gra ndërsa në **një rast (2% e rasteve)** një burrë dhe një grua janë viktima.


Këto të dhëna shpalosin një realitet tronditës në shoqërinë kosovare, ku dhuna është e drejtuar në mënyrë sistematike ndaj grave. Me **93% të burrave si të akuzuar** dhe **75% të grave si viktima**, vërehet një epërsi e dhunës sistematike patriarkale. Kjo e bën të qartë faktin notor se duhet një ndërhyrje e menjëhershme dhe gjithëpërfshirëse për të mbrojtur gratë dhe për të sfiduar normat shoqërore të rrënjosura tash e disa shekuj me rradhë. Institucionet përgjegjëse duhet të kenë parasysh gjithnjë programet rehabilituese të viktimave, megjithatë me ndryshimet e reja ligjore, është tejet e rëndësishme që fokus t'i ipet edhe programeve rehabilituese të kryerësve, që në këtë rast dominojnë meshkujt dhe për nga natyra e llojit të veprës kërkon trajtim të posaçëm.

Ndërsa sa i përket **raportit** mes viktimave dhe të akuzuarve, të dhënat pasqyrojnë se **61% e rasteve** ndodhin mes partnerëve bashkëshortorë. **18% e rasteve** ndodhin në marrëdhëniet

49 Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, 2023, neni 3.

prind-fëmijë dhe në **9% të rasteve** paraqiten **ish-partnerë**. Në raportin **vëllezër-motra** dhe në **marrëdhëniet jashtë-martesore** kemi një përqindje të vogël prej **3.5 % të rasteve totale**.


Grafiku 5. Aspekti gjinor dhe raporti mes palëve procedurale



3.2.1.3. Statusi ekonomik i palëve procedurale

Në paraqitjen e kriminalitetit ndikojnë faktorë të ndryshëm, qofshin ata endogjen (të brendshëm) apo ekzogjen (te jashtëm). Andaj, objekt i këtij hulumtimi është edhe **statusi ekonomik i viktimave si dhe të akuzuarve**. Nga monitorimi sistematik i rasteve të dhunës në familje, gjendja materiale brenda familjes, menaxhimi financiar por edhe varësia ekonomike mes viktimës dhe të akuzuarit mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në paraqitjen e dhunës në familje. Në bashkësitë familjare ku viktimë është e varur nga i akuzuari, kjo varësi krijon ambient të papërshtatshëm për viktimën për t'u zhvendosur në një tjetër banesë apo kur jemi tek menaxhimi financiar, ka raste në të cilat mungesa e menaxhimit adekuat, shkakton situata tensionuese në raport viktimë-i/e akuzuar.

Nga të dhënat e siguruar nga analizimi i një mostre prej 57 aktgjykimeve, **një pjesë e madhe e të akuzuarve, rreth 54%, kanë gjendje të dobët ekonomike**. Megjithatë, 40% e të akuzuarve i takojnë shtresës së mesme ekonomike. Në anën tjetër, ekziston një zbrazëtim **sa i përket gjendjes ekonomike të viktimave, ku në 70% të rasteve mungon ky informacion**, kjo vetëm sa e vështirëson epilogun mbi këtë çështje. Gjithsesi, të dhënat momentale janë tregues se shumë pak viktime kanë një status të qëndrueshëm financiar, duke qenë kështu si tregues i pozitës së tyre të pafavorshme në këto raporte.

Grafiku 6. Statusi ekonomik i të akuzuarve .

Përtej faktit se viktimat janë subjekt i dhunës në familje, situatën e vështirëson edhe më tutje gjendja e Strehimoreve por edhe Qendrave për Punë Sociale në Kosovë. Kjo sepse, të dy këto institucione janë të mbingarkuara ndërsa nga ana tjetër rezultojnë të kenë probleme sa i përket aspektit financiar, infrastrukturës së papërshtatshme por edhe burimeve të kufizuara njerëzore.⁵⁰ Shqetësim përbën çështja e riintegrit të viktimave pas daljes nga strehimoret, konkretisht çështja e sigurimit të strehimit por edhe punësimit të tyre, çka i shpie shumë viktima të rikthehen në ambiente të pasigurta për to.⁵¹ Një gjendje e tillë krijon një cikël retroaktiv dhe pa rezultate për viktimën, që mund të përfundojë sërish si subjekt i dhunës në familje, dhe për misionin e Strehimoreve dhe Qendrave për Punë Sociale për të çrrënjësuar këtë fenomen.

Andaj, duke i pasur parasysh këto të dhëna, vërehet nevoja urgjente që të parashihen programe për ngritjen e kapaciteteve ekonomike të viktimave fillimisht por pa përjashtuar në këtë mes edhe të akuzuarit pas përfundimit të dënimit. Konventa e Stambollit në nenin 16 të saj, parashesh po ashtu krijimin e programeve që synojnë të ndihmojnë autorët e dhunës për të ndryshuar sjelljen e tyre, me qëllim parandalimin e përsëritjes së dhunës.

3.2.2. Analiza e Politikës Ndëshkimore


Bazuar në të dhënat e siguruar përmes analizimit të 57 aktgjykimeve për periudhën e monitorimit, mund të themi se kemi një politikë ndëshkimore më të avancuar, me ç'rast **98.2% e rasteve janë aktgjykime denuese** ndërsa **1.7% janë aktgjykime refuzuese**. Kjo diferencë në përqindje reflekton qasjen më të ashpër që parimisht do duhet t'a karakterizonte politikën ndëshkimore ndaj dhunës në familje. Në **38 nga 57 raste në total**, janë shqiptuar **dënime alternative** ndërsa në **18 raste** janë shqiptuar **dënime kryesore**. Po ashtu është e rëndësishme të theksohet se në **22.8% të rasteve**, autorët janë **recidivistë**, në **50% të aktgjykimeve nuk përmendet nëse autorët kanë qenë recidivistë apo jo**, kurse në **26.3% të rasteve**, autorët kanë kryer veprën penale të dhunës në familje **për herë të parë**. Diferencat në llojin e dënimeve të shqiptuara janë shqetësuese, pasi nuk përfaqësojnë një politikë ndëshkimore adekuate, duke rritur gjasat për recidivizëm dhe duke penguar kryerësin të kuptojë peshën e

50 Dardana Fetahu, Analizë Tematike: Vlerësimi i Strehimoreve dhe Qendrave për Punë Sociale: Vlerësimi i Kapaciteteve për të Mbështetur të Mbijetuarit e Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë. Projekti JUST React. E qasshme në: [link to be inserted]

51 Po aty, fq. 15.

veprës penale të kryer. Po ashtu, identifikimi i recidivistëve është detyrim ligjor⁵², me qëllim të vlerësimit të veprës dhe autorit, sidomos tek vepra penale e dhunës në familje, e cila tashmë ka arritur përmasa të mëdha, ndërsa nga të dhënat e mësipërme kemi 50% të aktgjykimeve që nuk e kanë evidentuar këtë çështje.

Grafiku 7. Politika ndëshkimore e rasteve të dhunës në familje



Nga **18 denimet kryesore**, janë shqiptuar **9 dënime me burgim**, që përfaqësojnë dënime më të rënda dhe janë tregues i prezencës së recidivizmit të autorëve. Në një rast është shqiptuar **burgim me kusht** dhe në mënyrë **kumulative edhe dënim me gjobë**, duke i ofruar kështu mundësi autorit që të kuptojë peshën e veprës penale të kryer si dhe të ketë hapësirë për risocializim, që përbën qëllimin kryesor të sanksioneve penale. Po ashtu në **4 raste** të regjistruara, paraqitet **denimi me burgim si dhe denimi me gjobë**, me ç'rast reflektohet ashpërsia e denimeve nga ana e gjyqësorit. Vetëm **një rast** përfshinë **vërejtje gjyqësore**, që paraqet formën më të lehtë të ndëshkimit. Ndërsa janë **tre raste** në të cilat gjoba paraqitet si **denim kryesor**, denimet e tilla nuk kanë përputhje me seriozitetin e veprës penale të kryer dhe si të tilla nuk plotësojnë standardet ligjore për ndëshkim dhe mbrojtje të viktimave.

Tabela 4. Lloji i denimit kryesor.

Lloji i denimit	Numri i rasteve
Burgim	9 (nëntë) raste
Burgim dhe Gjobë	4 (katër) raste
Gjobë	3 (tre) raste
Burgim me kusht + Gjobë	1 (një) rast
Vërejtje Gjyqësore	1 (një) rast

Kur jemi tek kjo pikë, vlen të theksohet se gjatë analizimit të mostrës së aktgjykimeve, kemi gjetur se në disa raste veprat penale me të gjitha elementet e veprës së dhunë në **familje janë kualifikuar si lëndime të lehta trupore apo kanosje**. Një qasje e tillë duhet të ndryshojë domosdoshmërisht nga ana e institucioneve përgjegjëse për të mirën e përgjithshme. Politika ndëshkimore për veprat penale si lëndim i lehtë trupor apo kanosje janë joadekuate për pasojat që sjellë dhuna në familje. **Udhëzuesi i Gjykatës Supreme të Kosovës për politikën**

52 Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale i Kosovës, Neni 365. I qasshëm në: KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE

ndëshkimore⁵³ si dhe **Udhëzuesi për kualifikimin ligjor dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës**, përbëjnë dokumentet kyçe që duhet trajtuar nga ana e gjyqësorit.⁵⁴

Të dhënat tregojnë për një qasje të diferencuar sa i përket denimeve me gjobë dhe me burgim. **Mestarja e gjobave të shqiptuara është 439 EUR**, një shumë simbolike krahasuar me peshën e veprave penale të dhunës në familje. Ndërsa në anën tjetër, **gjoba maksimale prej 1500 EUR** dhe ajo **minimale prej 100 EUR** tregojnë për fleksibilitet të madh në trajtimin e rrethanave të rasteve.

Sa i përket **denimeve efektive me burgim**, mesatarja është vetëm **3.6 muaj**, periudhë mjaft modeste, me një minimum **prej 1 muaj dhe maksimum prej 12 muajsh**. Do të thotë se shumica nga denimet e shqiptuara me burgim janë dukshëm nën kufirin e paraparë me ligj për këto vepra penale, i cili është **3 vite**. Një trend i ngjashëm sa i përket politikës ndëshkimore ka qenë edhe vitin e kaluar ku maksimumi i dënimit efektiv me burgim ka qenë **1 vit e 4 muaj**.⁵⁵ Për sa i përket efektit të kësaj qasjeje në riintegrimin e personave të dënuar, mbetet e paqartë sidomos pas ndryshimeve të fundit të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, se si ka ndryshuar qasja e gjyqtarëve në ashpërsimin e dënimeve për këtë fenomen.

Tabela 5.

Lloji i dënimit	Mesatarja	Maksimumi	Minimumi
Dënim me Gjobë	439 EUR	1500 EUR	100 EUR
Dënim me Burgim	3.6 muaj	12 muaj	1 muaj

Trajektorja e rasteve të dhunës në familje këtë vit ka pësuar një rritje të dukshme, dhe fatkeqësisht, disa prej tyre kanë përfunduar me vrasje të viktimave që përbën fatkeqësi shoqërore fillimisht e nevojë për ndërjegjësim dhe detyrim për prioritizim institucional.

3.3 Përceptimet nga Terreni: Analiza përmes Monitorimit të Drejtpërdrejtë

Në korrik të vitit 2024, GLPS organizoi një fokus grup me pjesëmarrjen e monitoruesve të angazhuar në kuadër të projektit JUST React për periudhën monitoruese. Për periudhën e ciklit të dytë të monitorimit⁵⁶, monitoresit e angazhuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në Gjykatën Themelore në Prizren dhe në Mitrovicë, kanë ndjekur gjithësej **1094 raste** prej nga **22.1 %** shqyrtime fillestare, **72.6%** të rasteve janë shqyrtime kryesore dhe **5.2%** raste janë

53 Udhëzuesi i Gjykatës Supreme të Kosovës për politikën ndëshkimore. I qasshëm në: supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Sentencing_Guidelines_February_2018.pdf

54 Udhëzuesi për kualifikimin ligjor dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. I qasshëm në: [75340_Supreme_Court_DV_Guidance_June_2020.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2020/06/75340_Supreme_Court_DV_Guidance_June_2020.pdf)

55 Trajtimi Institucional i Rasteve të Dhunës në Familje, korrik 2022 – qershor 2023, fq. 20, i qasshëm në: [GLPS-Just-React-Annual-Report-Domestic-and-Gender-based-Violence-in-Kosovo.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2023/07/Just-React-Annual-Report-Domestic-and-Gender-based-Violence-in-Kosovo.pdf)

56 Memorandum i bashkëpunimit ndërmjet KGJK-së dhe GLPS-së, 2022

monitoruar shpallje të aktgjykimeve.⁵⁷ Nga statistikat e stave procedurale të monitoruara, mund të kuptohet qartë se ka qenë sfidë jashtëzakonisht e madhe që një rast të monitorohet që nga seanca fillestare e deri në shpallje të verdiktit final, kjo sepse tabela e njoftimeve sa i përket mbajtjes së seancave nuk ka qenë e përditësuar dhe si rezultat i kësaj, monitoruesit janë detyrar që të informohen për mbajtjen e seancave përmes frekuentimit sistematik të zyrave të gjyqtarëve.⁵⁸ Andaj, për sfidat e tilla si dhe ato më përmbajtësore sa i përket përvojave të tyre, kemi organizuar një diskutim me qëllim që të vihen në pah sfidat që ndikojnë në trajtimin efektiv të rasteve të dhunës në familje në Kosovë, nga perspektiva e secilit rajon të monitoruar.⁵⁹

Një nga çështjet më të rëndësishme të evidentuara ishte **mungesa e prokurorëve që trajtojnë rastet e dhunës në familje**, veçanërisht në **Gjykatat Themelore të Prishtinës dhe Mitrovicës**. Ngarkesa e madhe e punës për një numër të kufizuar prokurorësh ka rezultuar në vonesa të shumta në seancat gjyqësore, duke dëmtuar rëndë procesin gjyqësor si dhe viktimat.

Në një pikë tjetër, një faktor që ndikon po ashtu në zvarritje të seancave gjyqësore është vendndodhja e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe **linjat e kufizuara të transportit publik**, që e bëjnë të vështirë arritjen me kohë në seanca. Kjo ndikon veçanërisht tek personat me gjendje të dobët ekonomike, të cilat shpesh mbërrijnë vonë në seanca, duke u përballur kështu me një trajtim të pabarabartë dhe të padrejtë.⁶⁰

Një tjetër çështje shqetësuese e ngritur në këtë fokus grup ishte **mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë dhe policisë**, veçanërisht në zbatimin e urdhrave gjyqësorë, si për shembull në sjelljen e të paraburgosurve në seanca.⁶¹ Kjo mungesë koordinimi pengon seriozisht trajtimin efektiv të rasteve të dhunës në familje dhe rrit nevojën për bashkëpunim më të ngushtë midis këtyre institucioneve.

Një prirje shqetësuese në **Gjykatën Themelore të Mitrovicës** është përpjekja e gjyqtarëve për të ndërmjetësuar pajtimin mes viktimave dhe të akuzuarve, veçanërisht në procedurat civile për lëshimin e urdhrave mbrojtës. Shpeshherë, gjyqtarët përdorin fëmijët si arsye për të inkurajuar viktimat të japin një mundësi tjetër marrëdhënies.⁶² Duhet të ceket se një praktikë e tillë është totalisht në kundërshtim me legjislacioni vendor por edhe atë ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, monitoruesit kanë vërejtur se, në përgjithësi, gjykatat ofrojnë trajtim të barabartë për viktimat, pa dallim gjinor.

Në përgjithësi, rastet e dhunës në familje trajtohen relativisht shpejt, veçanërisht kur të pandehurit pranojnë fajësinë. Efikasiteti i gjykatave është përmirësuar në vitin e fundit, me shumicën e rasteve që përfundohen brenda një ose dy seancave. Megjithatë, **mungesa e përfaqësimit ligjor** për viktimat mbetet një çështje serioze. Kjo vërtetohet edhe nga analizat e mostrës së aktgjykimeve, shumica e viktimave, **71.9%, nuk kanë përfaqësim ligjor gjatë procedurave gjyqësore**. Vetëm një përqindje e vogël, **17.5%**, kanë avokatë personal, ndërsa **10.5% mbështeten nga Zyrtarët për Mbrojtjen e Viktimave**, duke lënë një hapësirë të madhe për përmirësime në këtë fushë.

57 Databaza e raportimit të zyrtarëve të monitorimit.

58 Po aty.

59 Fokus grup i organizuar me zyrtarët e monitorimit, me date 11 korrik 2024.

60 Po aty.

61 Po aty.

62 Po aty.

Tabela 6. Përfaqësimi ligjor i viktimave

Lloji i Përfaqësimit Ligjor	Përqindja e Viktimave
Nuk ka përfaqësim ligjor	71.9%
Avokat	17.5 %
Zyrtar për Mbrojtjen e Viktimave	10.5 %

Në përfundim, ky fokus grup nxori në pah se, pavarësisht disa përmirësimeve, ende mbeten sfida të mëdha për t'u adresuar, për të garantuar që çdo viktimë e dhunës në familje të ketë qasje të barabartë në drejtësi dhe mbështetje adekuate.

Gjetjet dhe rekomandimet

Gjetjet kryesore që kanë rezultuar nga kjo analizë janë:

1. Republika e Kosovës ka krijuar një kornizë ligjore të konsoliduar sa i përket trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, ekziston hapësirë për plotësim sa i përket Dhunës me Bazë Gjinore Online dhe Femicidit. Poashtu, zbatimit të plotë të kornizës ligjore në fuqi.
2. Gjatë **periudhës korrik 2023 – qershor 2024**, në Policinë e Kosovës janë raportuar gjithsej **2,856 raste** të dhunës në familje, duke shënuar një rritje prej **4.4%** krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kur ishin raportuar **2,735 raste**.
3. Incidenca e dhunës në familje sipas rajoneve kryesohet nga **Mitrovica Veriore**, e pasuar nga Peja, Prishtina, Gjilani, Mitrovica Jugore, Gjakova, Prizreni dhe Ferizaj.
4. Në **79% të rasteve të raportuara, viktimat janë gratë**, një fakt që dëshmon se gratë vazhdojnë të jenë të prekura në mënyrë joproporcionale nga dhuna në familje, duke reflektuar ndikimin e thellë të strukturave patriarkale të rrënjosura në shoqëri.
5. Sipas rasteve të raportuara, **grupmosha më e prekur** si për viktimat ashtu edhe për arrestuarit **është ajo 30-40 vjeç**. Kjo grupmoshë përfaqëson **25.4% të totalit të viktimave** dhe **26% të personave të arrestuar**.
6. Në mbi **90% të rasteve të raportuara** për dhunë në familje në Prokurori, **janë ngritur aktakuza**.
7. Për dallim nga incidenca e raportimeve në nivel rajonal, **rajoni i Pejës shënon incidencën më të lartë të aktakuzave**, duke përfaqësuar dyfishin e rasteve të raportuara në Polici.
8. Mungesa e të dhënave mbi aspektin gjinor për të akuzuarit dhe viktimat në Prokurori thekson nevojën për bashkëpunim ndërinstytucional dhe krijimin e një **database të përbashkët**, për të siguruar një trajtim të unifikuar të rasteve të dhunës në familje. Shembull për t'u ndjekur është **Spanja**, e cila ka zhvilluar "**Sistemin Integral të Monitorimit të Dhunës Gjinore (VioGén)**".
9. Gjatë monitorimit janë evidentuar disa raste me të gjitha elementet e veprës penale të dhunës në familje, ndërsa **janë kualifikuar si lëndim i lehtë trupor apo kanosje**.
10. Për periudhën monitoruese, Prokuroria ka pasur një normë trajtimi të lëndëve prej 102%, duke zgjidhur më shumë raste sesa janë pranuar, ndërsa Gjykatat kanë arritur një normë zgjidhjeje prej 74.7%. Norma e qarkullimit është 2.79 në Prokurori dhe 1.39 në Gjykata, që reflekton menaxhim efikas.
11. Nga të dhënat e siguruar nga KGJK, në **701 raste** është shqiptuar dënim fajësues me **297 raste** të cilat kanë përfunduar me **dënim me kusht dhe 94 raste dënim me burgim**.
12. Nga analiza e aktgjykimeve, **dhuna psikologjike** paraqitet si lloji më i shpeshtë i dhunës në familje, e pasuar nga dhuna fizike.
13. **61% e rasteve** të dhunës në familje ndodhin mes partnerëve intimë. Ndërkaq, rreth **54% e të akuzuarve** për dhunë në familje i përkasin një gjendjeje të dobët ekonomike, ndërsa për **70% të viktimave** mungojnë të dhënat mbi statusin e tyre ekonomik.

14. Gjykatat e shpallën fajtor të akuzuarin në **98.2% të rasteve** megjithatë nuk është përdorur politika ndëshkimore adekuate sepse kemi një dominancë të denimeve alternative. Ndërsa, në 50% të aktgjykimeve nuk përmendet nëse autorët kanë qenë recidivistë apo jo.

15. Në **71.9% të rasteve**, viktimat nuk kanë përfaqësues ligjor gjatë procedurave gjyqësore.

Nga këto gjetje, JUST REACT jep këto rekomandime për institucionet të cilat merren **me rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore**:

1. Qeveria e Kosovës/ Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë, të të ndërmarrin masa për të siguruar zbatimin e plotë të Ligjit nr.05/L -003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, i cili është në fuqi nga viti 2015;
2. Rritja e efikasitetit të Policisë së Kosovës përmes krijimit të strategjive të përshtatura për parandalimin dhe hetimin e rasteve të dhunës në familje;
3. Të krijohet një databazë ndërinstitucionale, e ngjashme me sistemin VioGén në Spanjë, që do të përfshinte Policinë, Prokurorinë, Gjykatat dhe Qendrat për Punë Sociale. Kjo databazë do të mundësonte ndjekjen e rasteve të dhunës në familje në kohë reale, duke përmirësuar koordinimin ndërmjet institucioneve dhe duke siguruar mbështetje dhe mbrojtje më efektive për viktimat përmes vlerësimit të rrezikut dhe masave parandaluese;
4. Rekomandohet përfundimi apo ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe teknologjike në Gjykata për të përmirësuar efikasitetin dhe për të ulur kohëzgjatjen e trajtimit të rasteve;
5. Të sigurohet zbatimi i ndryshimeve në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale nga ana e Gjykatave dhe Prokurorisë, duke aplikuar politikë më të ashpër ndëshkimore si dhe procedura të përshtetura gjyqësore;
6. Rekomandohet që gjykatat të përfshijnë në aktgjykime informacionin nëse autorët e veprave penale kanë qenë recidivistë apo jo në përputhje me Kodin e Procedurës Penale;
7. Qeveria e Kosovës/ Ministria e Drejtësisë të parashohë programe për ngritjen e kapaciteteve ekonomike të viktimave dhe të akuzuarve pas përfundimit të dënimit;
8. Mbrojtësit e Viktimave të jenë të pranishëm në të gjitha seancat gjyqësore dhe të asistojnë në përgatitjen e parashtrësave dhe mjeteve të tjera juridike.



Funded by
the European Union



Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje

Korrik 2023 – Qershor 2024



Grupi për Studime
Juridike dhe
Politike

